



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 14-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 29.03.2023, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Anila Reqica-Llugiqi DKRS
2. Safete Amerllahu, DGJK
3. Latif Ramadani, DBF
4. Burim Rrustemi, DSHPM SH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, të cilën e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.
3. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023.
4. Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.

5. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

6. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër.

7. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.

Pastaj tha i kemi edhe 3 pika shtesë të cilati lexoi në vazhdim.

9. Propozim Vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës

10. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve

11. Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.350/01-5618 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (2023 - 2027) i datës 31.01.2023

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim rendin e ditës ,pastaj u konstatua se me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 13-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 13-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit nga DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se rruga Afrim Zhitia, a është rruga për fshatin Konjuh

Latif Ramadani, po ajo rrugë është.

Egzona Bytyqi, tha se në Qylagë a do të asfaltohen të gjitha rrugicat?

Latif Ramadani, tha se po do të mundohemi të i përfshijmë të gjitha rrugët.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Anila Reqica –Llugiqi, nga DKRS e cila i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e kam edhe një pyetje, pse nuk ka mbet ashtu siç e ka propozuar, bashkësia Islame, por ka mbet 15 euro më pak, pse janë hiç këto 15 euro Ne si grup i PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

Anila Reqica, tha sa i përket pyetjes se parafolësit, nuk e dijë?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi, nga DKRS e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim pasi që zyrtarët e komunës e meritojnë, por e kam edhe një kërkesë që të jetë një raport se si janë shpenzuar këto mjete

Alban Salihu, tha se edhe unë pajtohem me Arsimin që të ketë një raport nga sindikata se si janë shpenzuar ato mjete.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e kanë raportin sindikata?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së, kemi kërkuar një raport nga kompania pastrimi, dhe jam skeptik se kjo kompani do të bëjë diçka. E dyta, është mirë, që kur te ju epet kjo pronë, të përfshihet një pjese që te dërzohen edhe mbeturinat inerte, pasi qytetarët nuk po kanë ku ti hedhin mbeturinat ndërsa po dënohen nga inspektorati. Ju propozoj që te këtë, një vend te till.

Alban Salihu, tha po pajtona me Arsimin që te këtë një vend, ku do te hidhen mbeturinat inerte.

Burim Rustemi, tha se është një vend për hedhjen e mbeturinave që e ka nda kuvendi para disa viteve, po ashtu edhe kompania pastrimi i merr mbeturinat inerte te shpija vetëm që duhet te bëhet pagesa për to.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se cili është qëllimi i këtij propozim vendimi?

Daut Azemi, tha se qëllimi është që ato toka të cilat kanë mbetur papunuara të punohet nga dikush?

Safete Amerllahu, tha se në mendojmë që çmimi fillesatë për hektar të jetë 50 euro, pastaj ju si kuvend vendosni?

Alban Salihu, tha se unë kisha thanë të ju jepet edhe falë me kushtin që të merr dikush që të punon e jo dikush që vetëm të merr e nuk punon asgjë në to.

Asrim Jashari, tha edhe unë shpresoj që do të merr dikush që do të punoj në to, e jo me të marr e mos me punuar asgjë siç na ka ndodhur me disa prona me herët. Po ashtu e kam edhe një propozim vendim, që nëpër fshatra prona publike të cilat i kanë qytetarët përballë shtëpive të mirëmbahen nga kompania pastrimi apo dikush tjetër.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a nuk e kemi mundësinë që të jetë i njëti komision në të gjitha prona apo për çdo pronë duhet të jetë komision i veçantë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se sa ka qenë ligji i vjetër në fuqi kemi pas të drejt një komision për të gjitha prona, ndërsa me ligjin e ri duhet për secilën pronë komision i veçantë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IX

Propozim Vendim paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

X

Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit

XI

Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.350/01-5618 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (2023 - 2027) i datës 31.01.2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ka qenë mirë qe me pas të bashkëngjitur edhe shkresën e ministrisë ky vendim, ose është mirë qe të na e dërgoni edhe neve ta shohim këtë shkresë.

Daut Azemi, tha se mund te ua dërgojmë ne email pas mbledhjes së KPF-së, shkresën e mistrisë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:40

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi